




Ndërtesa e Elektrokovës  
Bulevardi Bill Clinton nr.3  
Prishtinë 10000  
Republika e Kosovës

Elektrokosova Building  
311 Clinton Boulevard No.3  
Prishtina 10 000  
Republic of Kosovo



KOMPANIA KOSOVARE PËR DISTRIBUIM DHE FURNIZIM ME ENJERJI  
KOSOVO ELECTRICITY DISTRIBUTION AND SUPPLY COMPANY  
KOSOVSKO PREDAJEČE ZA DISTRIBUCIJU I SNABOEVANJE ELEKTROENERGIJE  
KEDS - SH.A.  
Nr. 5125 Dt. 20-06-2022  
PRISHTINË/A 1


## Kriteret teknike për kyçje të gjeneratorëve për vetë-konsum në rrjetin e OSSH-së



## Përmbajtja

1. Qëllimi .....	3
2. Fushëveprimi.....	3
3. Struktura e dokumentit.....	3
4. Përkufizimet.....	3
5. Baza rregullative .....	3
5.1 Rregulla për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme .....	3
5.2 Rregulla e Procedurës së Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë.....	4
5.3 Kodi i Rrjetit dhe Kodi i Matjes së OSSH .....	4
6. Aplikimi për kyçje .....	4
7. Kriteret e përcaktimit të fuqisë maksimale gjeneruese për vetë-konsum.....	5
7.1 Kriteret e përgjithshme që zbatohen për të gjitha rastet: .....	5
8. Skemat e kyçjes në rrjet .....	6
8.1 Kategorizimi i skemave sipas fuqisë së kërkuar gjeneruese: .....	6
Skema 1: Kategoria I: $P_{\max\_gen} \leq 10 \text{ kW}$ .....	6
Skema 2.1: Kategoria II: $10 \text{ kW} < P_{\max\_gen} \leq 50 \text{ kW}$ , Rasti 1 .....	7
Skema 2.2: Kategoria II: $10 \text{ kW} < P_{\max\_gen} \leq 50 \text{ kW}$ , Rasti 2 .....	7
Skema 3.1: Kategoria III: $> 50 \text{ kW}$ , Rasti 1 .....	8
Skema 3.2: Kategoria III: $> 50 \text{ kW}$ , Rasti 2.....	8
9. SHTOJCAT.....	9
9.1 SHTOJCA 1. FORMULARI I KËRKESËS PËR KYÇJE.....	9





## 1. Qëllimi

Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i kritereve teknike për kyçje paralel me rrjetin e OSSH-së të gjeneratorëve për vetë-konsum.

## 2. Fushëveprimi

Dispozitat e këtij dokumenti janë të aplikueshme për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes që ofron shërbime të energjisë elektrike, për përdoruesit ekzistues që shfrytëzojnë këto shërbime, si dhe për përdoruesit e ardhshëm të sistemit të shpërndarjes të cilët kërkojnë kyçje të gjeneratorëve për vetë-konsum në rrjetin elektrik.

## 3. Struktura e dokumentit

Ky dokument përmban:

1. Aplikimin për kyçje
2. Kriteret e përcaktimit të fuqisë maksimale gjeneruese për vetë-konsum
3. Skemat e kyçjes në rrjet
4. Shtojcat

## 4. Përkufizimet


1. **Aplikuesi (parashtruesi i kërkesës)** - është personi fizik ose juridik, i cili aplikon për kyçje të gjeneratorit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE-ve) për vetë-konsum në rrjetin e shpërndarjes.
2. **Konsumator prodhues** - është konsumatori i energjisë elektrike që në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin lokacion është pronar i mikro-gjeneratorit të BRE-ve, të kyçur në rrjet dhe me të drejtë të vetë-konsumit të energjisë elektrike të gjeneruar, si dhe dërgimin e tepricës së energjisë elektrike të gjeneruar të furnizuesi.
3. **Gjeneratorët për vetë-konsum** - janë konsumatorët prodhues që do të mund të ofrojnë energjinë e prodhuar në rrjetin e energjisë elektrike për konsum në të ardhmen ose do t'i paguajnë furnizuesit energjinë e konsumuar në rast të bilancit negativ.
4. **Pëlqimi Elektroenergjetik** - dokumenti zyrtar i lëshuar nga OSSh, e ku përshkruhen kushtet teknike dhe administrative për kyçje.
5. **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (në tekstin e mëtejme: OSSH)** - nënkupton personin fizik ose juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe, sipas nevojës, zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në një zonë të caktuar, si dhe ku është e mundur interkonektorët e tij me sistemet tjera, si dhe për sigurimin e aftësisë afatgjate të sistemit për të mbuluar kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë elektrike.

## 5. Baza rregullative

### 5.1 Rregulla për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme

Ky rregull përcakton parimet e gjeneratorëve për vetë-konsum të energjisë elektrike nga Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme (BRE), metodologjinë e llogaritjes, aplikimin e gjeneratorëve për vetë-konsum dhe procedurën e kyçjes.





## 5.2 Rregulla e Procedurës së Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja bazuar në Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë


Ky rregull përcakton procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për kapacitet e vogla gjeneruese bazuar në BRE.

## 5.3 Kodi i Rrjetit dhe Kodi i Matjes së OSSH

Kodi i Rrjetit i OSSH-së dhe Kodi i Matjes së OSSH-së përcakton kërkesat inxhinierike dhe teknike të kycjes, si dhe përcakton edhe kufirin ndërmjet operatorëve dhe të shfrytëzuesve të sistemit të shpërndarjes.

## 6. Aplikimi për kyçe

1. Të drejtë aplikimi ka çdo konsumator i fundit i energjisë elektrike i cili është i regjistruar tek Furnizuesi si dhe është i kyçur në nivelin e tensionit të ulët (TU).
2. Për çdo aplikacion të ri duhet të jenë të bashkangjitura dokumentet e mëposhtme:
  - Aplikacioni për konsumatorë prodhues
  - Autorizimi i klientit për instaluesin/zhvilluesin e projektit
  - Licenca e kompanisë projektuese (profili elektroenergjetik), dhe diploma e inxhinierit zhvillues të projektit
  - Projekti elektrik, i cili në këtë fazë përfshin:
    - fuqinë e kërkuar si konsumator prodhues (kW<sub>p</sub>)
    - lloji i BRE-ve (solar, me erë, me ujë, biomasë, biogazet etj.)
    - vlerësimi vjetor i prodhimit të energjisë (kWh) nga gjeneratori
    - konsumin e energjisë nga rrjeti në 12 muajt e fundit (kWh)
    - vlerësimi vjetor neto i tepicës së energjisë (kWh) të injektuar në rrjet
    - Informacion rreth komponentëve të sistemit, duke përfshirë:
      - Modulin fotovoltaik
        - i. Tipi
        - ii. Prodhuesi
        - iii. Modeli
        - iv. Kapaciteti modulit (W<sub>p</sub>)
      - Invertori
        - i. Nr. i inverterëve të instaluar
        - ii. Kapaciteti i inverterit (kW)
        - iii. Tipi: një-fazor, tre-fazor
        - iv. Prodhuesi
        - v. Modeli
        - vi. Faktori i fuqisë
      - Bateritë (nëse ka)
        - i. Kapaciteti i baterive (kWh)
        - ii. Tipi
        - iii. Prodhuesi




## 7. Kriteret e përcaktimit të fuqisë maksimale gjeneruese për vetë-konsum

1. Kriteret teknike sa i përket kapaciteteve gjeneruese të gjeneratorëve për vetë-konsum duhet të shtjellohen në mënyrë individuale duke marrë parasysh kufizimet në nënstacione dhe stabilimente tjera si dhe të dhënat specifike për secilin konsumatorë.
2. Kriteret e propozuara në vijim tregojnë kushtet në të cilat gjeneratorët për vetë-konsum mund të lidhen në rrjetin e OSSH-së pa pasur nevojë të kryhen studime të hollësishme të rrjetit. **Aplikacionet që nuk plotësojnë këto kritere propozohen të ndjekin një proces alternativ, i cili mund të kërkojë studime të hollësishme të rrjetit.**
3. Gjatë përgatitjes së Pëlqimit Elektroenergjetik, OSSH-ja do të marrë në konsideratë kushtet e mëposhtme, pas inspektimit në terren:
  - i. Fuqia e kërkuar gjeneruese (kWp);
  - ii. Kapacitetin e kontraktuar (kW);
  - iii. Profili vjetor i ngarkesës së konsumatorit (kW) (nëse ka matje 15-minutëshe të disponueshme);
  - iv. Numri i konsumatorëve në TS, fuqia e instaluar dhe profili i ngarkesës së TS-it prej nga furnizohet konsumatori;
  - v. Kapacitetet e autorizuara për gjenerim, duke filluar nga niveli i daljeve 0.4kV e deri në nivelin 35/10(20)/6kV të nënstacioneve;
  - vi. Kapaciteti i linjave dhe stabilimenteve tjera energjetike që ndërlihen me furnizimin e konsumatorit deri në TS;
  - vii. Vlerësimi vjetor i prodhimit të energjisë nga gjeneratori (kWh/vit);
  - viii. Konsumin e energjisë në vitin paraprak (kWh);

### 7.1 Kriteret e përgjithshme që zbatohen për të gjitha rastet:

1. Kapaciteti gjenerues i kërkuar  $\leq$  Kapaciteti i kontraktuar;
2. Kapaciteti gjenerues i kërkuar  $\leq$  limiti i sipër sipas legjislacionit;
3. Energjia e tepërt e gjeneruar e injektuar në rrjet (kWh) nuk duhet të kalojë 20% të konsumit total (kWh) të 12 muajve të fundit, vlen për rastet mbi 10kW;
4. Nëse ka të dhëna të disponueshme të profilit vjetor të ngarkesës, kapaciteti gjenerues i kërkuar nuk duhet të jetë më i madh se vlera mesatare e:
  - a. 10% të vlerave të larta të fuqisë aktive (P) gjatë periudhës Qershor - Gusht, në intervalin 7:00 - 19:00.
  - b. Nëse nuk ka të dhëna të disponueshme atëherë:  $P_{gen} \leq 70\% * \text{kapaciteti i kontraktuar}$ ;
5. Kapacitetet totale të instaluar të gjenerimit nga të gjithë konsumatorët prodhues të furnizuar nga daljeve e përbashkëta të TU-së duhet të jenë më të vogla se kapaciteti i kabullit;
6. Kapacitetet totale të instaluar të gjenerimit nga të gjithë konsumatorët prodhues të kyçur në të njëjtin trafostacion (në pronësi të OSSH-së) duhet të jenë deri në 50% të fuqisë së instaluar të transformatorit TM/TU ( $P_{dg} \leq 0.5 S_n$ ). Për trafostacionet private kufiri do të jetë deri në 70% ( $P_{dg} \leq 0.7 S_n$ ).
7. Kufijtë në nivelin e daljeve 10(20),(6)kV:
  - a. Kapacitetet totale të instaluar të gjenerimit nga BRE-të duhet të jenë më të ulëta se 60% e kapacitetit termik të linjës 10(20),(6)kV ( $P_{dg} \leq 0.6 P_{th\_line}$ );
8. Kufijtë në nivelet e nënstacioneve 35/10(20)/6kV/kV:
  - 8.2 Kapacitetet totale të instaluar të gjenerimit nga BRE-të duhet të jenë më të ulëta se 30% e fuqisë së instaluar të nënstacionit;

Për kapacitet të gjenerimit do të përvetësohet vlera më e ulët e vlerësuar sipas kritereve më lartë.



## 8. Skemat e kyçjes në rrjet

### 8.1 Kategorizimi i skemave sipas fuqisë së kërkuar gjeneruese:


1. **Kategoria I:** Gjeneratorët deri në 10 kW ( $P_{\max\_gen} \leq 10 \text{ kW}$ )
2. **Kategoria II:** Gjeneratorët nga 10 kW deri në 50 kW ( $10 \text{ kW} < P_{\max\_gen} \leq 50 \text{ kW}$ )
3. **Kategoria III:** Gjeneratorët mbi 50 kW ( $P_{\max\_gen} > 50 \text{ kW}$ )

Shënim: Për kategoritë II dhe III, do të kemi dy skema të ndryshme të kyçjes varësisht nga vendndodhja e pikës matëse. Për secilën nga kategoritë do të kemi pra:


Rasti 1: Kur matja e energjisë elektrike është në shtyllë, panel për montim të jashtëm apo në afërsi të trafostacionit.

Rasti 2: Kur është një matje e vetme e energjisë elektrike për një konsumatorë në një trafostacion.


#### Skema 1: Kategoria I: $P_{\max\_gen} \leq 10 \text{ kW}$



*[Handwritten signatures and initials in blue ink]*




Skema 2.1: Kategoria II:  $10 \text{ kW} < P_{\text{max\_gen}} \leq 50 \text{ kW}$ , Rasti 1




**Shënim:** Në rastet kur ormani distributiv i konsumatorit ka hapësirë të mjaftueshme për kyçje të gjenerimit sipas skemës së propozuar nga KEDS për rastin nr.1 të kategorisë së II-të, si dhe është në gjendje të rregullt teknike dhe/apo me mundësi modifikimi atëherë do të mund të shfrytëzohet i njëjti orman me kusht që të respektohet logjika e skemës.


Skema 2.2: Kategoria II:  $10 \text{ kW} < P_{\text{max\_gen}} \leq 50 \text{ kW}$ , Rasti 2



**Shënim:** Në rastet kur kablo e cila furnizon njëren nga objektet e konsumatorit në të cilin ndodhen panelet solare i plotëson kushtet teknike për kyçje, atëherë gjenerimi mund të kyçet sipas skemës 2.1.




Skema 3.1: Kategoria III: > 50 kW, Rasti 1



**Shënim:** Në rastet kur ormani distributiv i konsumatorit ka hapësirë të mjaftueshme për kyçje të gjenerimit sipas skemës së propozuar nga KEDS për rastin nr.1 të kategorisë së III-të, si dhe është në gjendje të rregullt teknike dhe/apo me mundësi modifikimi atëherë do të mund të shfrytëzohet i njëjti orman me kusht që të respektohet logjika e skemës.

Skema 3.2: Kategoria III: > 50 kW, Rasti 2



**Shënim:** Në rastet kur kablo e cila furnizon njëren nga objektet e konsumatorit në të cilin ndodhen panelet solare i plotëson kushtet teknike për kyçje, atëherë gjenerimi mund të kyçet sipas skemës 3.1.






## 9. SHTOJCAT

### 9.1 SHTOJCA 1. FORMULARI I KËRKESËS PËR KYÇJE

Nr. i referencës.: Click here to enter text.  
 Data: Click here to enter a date.

Pjesa 1: Të dhënat e konsumatorit		Pjesa 2: Të dhënat e personit të autorizuar (nëse ka)																																																																																
Emri, Mbiemri: Click here to enter text. Nr. i ID: Click here to enter text. Shifra e konsumatorit: Click here to enter text. Adresa: Click here to enter text. Nr. i tel: Click here to enter text. E-mail adresa: Click here to enter text.		Emri, Mbiemri: Click here to enter text. Nr. i ID.: Click here to enter text. Emri i kompanisë: Click here to enter text. Nr. i biznesit të kompanisë: Click here to enter text. Adresa: Click here to enter text. Nr. i tel: Click here to enter text. E-mail adresa: Click here to enter text.																																																																																
Pjesa 3: Të dhënat teknike		Pjesa 4: Të dhënat e sistemit fotovoltaik (FV)																																																																																
Kapaciteti i kontraktuar: Click here to enter text.kW Veprimtaria e objektit: Click here to enter text. Lloji i BRE: Solar <input type="checkbox"/> Me erë <input type="checkbox"/> Biomassë <input type="checkbox"/> Tjetër: (Specifiko) Click here to enter text. Kapaciteti gjenerues i kërkuar: Click here to enter text. kW <sub>p</sub> Instalimi i baterive për ruajtje të energjisë: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> ;		a) Modulet FV <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Tipi: Monokristalinë <input type="checkbox"/> Polikristalinë <input type="checkbox"/> Tjetër: Click here to enter text.</li> <li>ii. Prodhuesi Click here to enter text.</li> <li>iii. Modeli Click here to enter text.</li> <li>iv. Fuqia nominale Click here to enter text.W<sub>p</sub></li> </ul> b) Invertori <ul style="list-style-type: none"> <li>i. Nr. invertorëve të instaluar: Click here to enter text.</li> <li>ii. Fuqia e invertorit Click here to enter text.kW</li> <li>iii. Tipi: Një-fazor <input type="checkbox"/> Tre-fazor <input type="checkbox"/></li> <li>iv. Prodhuesi Click here to enter text.</li> <li>v. Modeli: Click here to enter text.</li> <li>vi. Faktori i fuqisë cosphi : Click here to enter text.</li> </ul>																																																																																
<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2"></th> <th colspan="2">Konsumi</th> <th rowspan="2">Vlerësimi i prodhimit</th> <th rowspan="2">Vlerësimi tepriçës së injektuar në rrjet</th> </tr> <tr> <th>Viti</th> <th>kWh</th> <th>kWh</th> <th>kWh</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>Muaji</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Janar</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Shkurt</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Mars</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Prill</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Maj</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Qershor</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Korrik</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Gusht</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Shtator</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Tetor</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Nëntor</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Dhjetor</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> <tr><td>Total</td><td></td><td></td><td></td><td></td></tr> </tbody> </table>			Konsumi		Vlerësimi i prodhimit	Vlerësimi tepriçës së injektuar në rrjet	Viti	kWh	kWh	kWh	Muaji					Janar					Shkurt					Mars					Prill					Maj					Qershor					Korrik					Gusht					Shtator					Tetor					Nëntor					Dhjetor					Total					Pjesa 5: Deklarata  Duke nënshkruar këtë formular, unë deklaroj se: Unë e përfaqësoj aplikantin e objektit dhe informacioni i dhënë më sipër është i vërtetë në njohuritë dhe besimin tim. Më tej, jam dakord të respektoj specifikimet, termat dhe kushtet e përcaktuara në udhëzimet e zbatueshme dhe rregulloret përkatëse, të ndryshuara herë pas here.  Emri, Mbiemri: Click here to enter text. Data: Click here to enter a date. Nënshkrimi:	
	Konsumi		Vlerësimi i prodhimit	Vlerësimi tepriçës së injektuar në rrjet																																																																														
	Viti	kWh			kWh	kWh																																																																												
Muaji																																																																																		
Janar																																																																																		
Shkurt																																																																																		
Mars																																																																																		
Prill																																																																																		
Maj																																																																																		
Qershor																																																																																		
Korrik																																																																																		
Gusht																																																																																		
Shtator																																																																																		
Tetor																																																																																		
Nëntor																																																																																		
Dhjetor																																																																																		
Total																																																																																		



KEDS për përgatitjen e këtij dokumenti ka marrë parasysh edhe komentet e dërguara nga kompanitë të cilat merren me zhvillimin e projekteve të energjisë solare si dhe diskutimeve të bëra në takimin e mbajtur më dt.01.04.2022.

Përgatitur nga:

Drejtor i Përkujdesit  
(KEDS)

Sabri TËRNAVA

Drejtor i Sistemit të Operimeve

Bujar JUPAJ

Drejtor i Investimeve

Faruk GJUKAJ

Drejtor i Humbjeve

Shukri ALIU

Drejtor për Hulumtim & Zhvillim

Turan KOCABAYRAKTAR

Menaxher për Planifikim dhe  
Projekte

Aden HAJDINI

Menaxher për BRE

Albiona LALINOVCI

Aprovuar nga:

Kryeshefi Ekzekutiv

Alpin DOGAN